

MUHARREM GASHI

**RRETH DISA ASPEKTEVE TË SË FOLMES SHQIPE TË QYTETIT
TË PRIZRENIT DHE RRETHINËS ME GJUHË TË MJEDISIT
NË KONTAKT**

Okupimet shtypëse dhe antishqiptare nxitën shpërngulje të mëdha, kryesisht të elementit shqiptar në Turqi¹ e vende të ndryshme, së paku deri në fundin e dhjetëvjetëshit të shtatë të shekullit tonë. Areali i së folmes së qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij në këto vite shquan shifra shumë të ndjeshme, madje ne do thoshim denigruese të migrimit në vende aziatiko-evropiano-muslimane. Këto shifra janë të përafërta me vetë shtimin natyror të elementit shqiptar në këtë anë. Në dhjetëvjetëshat e viteve 1961, 1971 e 1981 të shekullit që e lamë pas shquhet kjo pasqyrë e shtimit natyror me atë të emigrimit të kësaj popullate për Turqi: më 1961/71 shtimi natyror kapte shifrën 24.605 banorë, për afër shifrës emigruese të 3066 banorëve, ndërsa në vitet 1970/81 kapte shifrën 32.514 banorëve plus shifrën imigruese të 4.298 banorëve të elementit shqiptar². Ndryshimeve të elementit folës të trevës së Grykës së Lumbardhit, sikurse edhe gjithë kësaj treve do t'i paraprijë kujtesa e hidhur e shkatërrimit me përmasa të mëdha të objekteve kapitale të kulturës shpirtërore e materiale që bëri pushtimi e stacionimi i armatës së tretë serbe në këtë anë, pastaj pushtimi bullgar si dhe ai i Nemajicëve, më 1227.

Në anën e majtë të rrjedhjes së Lumbardhit, në këtë areal ndodhen varrezat bizantine, ndërsa në anën tjetër të Lumbardhit shtrihet një *gjerdan shpellash* (13 sosh), të cilat supozohen nga koha e gurit neolit nga edhe kanë lehtësuar jetën e njeriut. Megjithëkëtë këto treva duhet të përimitohen që të vërtetohet koha bashkë me ndërndikueshmërinë e këtyre bashkësive gjuhësore që e përdorin gjuhën shqipe deri në komunikimin e sotëm. Elementi sllav gjatë sundimit të vet, në të folmet e Prizrenit me rrethinë ka insistuar në ndryshimin e shumë elementeve të kulturës shpirtërore, materiale, ekonomike, politike, ku synimi ka qenë i drejtuar ndaj të gjithëve që shquanin elementin shqiptar, pra jo vetëm ndaj atyre me përkatësi muslimane. Nisje, në këtë aspekt mund të shihet "Fjalori i L. Kujunxhiçit" i cili nuk shquante saktë trevën e lëndës së vet gjuhësore. Këtë më mirë do ta pasqyrojë studiuesi H. Agani, së pari në punimin e diplomës: "Disa veçori fonetike e morfologjike që ka e folmja e Gjakovës (qytet)", më pastaj edhe në monografinë "Cila është treva gjuhësore e Fjalorit të L. Kujunxhiçit?"³. Autori arrin në përfundim se fjalori i L. Kujunxhiçit, Louis Arbanasit, që, edhe sipas

¹ A. Pushka, *Ciklet migruese të popullsisë së Kosovës dhe më gjerë*, GJASSHH, IA, Prishtinë, 1991, f. 8.

² A. Pushka, *Përcaktimi i viseve migruese*, "Shpërngulja e shqiptarëve", Prishtinë, 1992, f. 291.

³ H. Agani, *Cila është treva gjuhësore e Fjalorit të L. Kujunxhiçit?*, në "Gjurmime albanologjike", SSHF, nr. 2. 1968/ 1969, f. 380.

Joklit është pseudonim i vetë autorit, L. Kujunxhiçit, pasqyron shqipen e një treve më të gjerë që kap të folmen e Rahovecit, atë të qytetit të Prizrenit dhe në raste të veçanta edhe elemente të caktuara të së folmes së qytetit të Gjakovës. *Fjalori*, si i tillë, luajti rol pozitiv për studiues, por gabimet e shumta keqinformuan albanologë të njohur, të cilët gjuhën e përdorur e konsideruan si të folme të arealit të Gjakovës⁴.

Në anën tjetër bashkësia shqiptare vazhdimisht është përpjekur t'i mbrojë elementet që shquanin etninë dhe çështjen kombëtare, megjithëkëtë janë prekur emrat e vendeve, emrat e njerëzve dhe në përgjithësi onomastika. Shpeshherë toponimet janë përkthyer nga baza e tyre e parë origjinale në shërbim të elementit pushtues. Kështu krahas emërtimeve në gjuhën shqipe kemi edhe emërtime në gjuhën sllave si dhe atë boshnjake, por ka mjaft raste edhe kur toponimi i njëjtë është përkthyer edhe në gjuhën turke, që njëherësh pasqyron kohën e pushtimit osman. Më tutje Lumi i Prizrenit, në kohën e pushtimeve sllave vazhdimisht shquhet *Bistrica e Prizrenit* (rrjedhë e bardhë, e shpejtë, e pastër) ndërsa në gojën e elementit shqiptar gjithmonë është përkufizuar si lumë i bardhë, lumë që gjatë rrjedhës shkumbëzon bardhë, pra lumë i bardhë, *Lumbardh*⁵ ashtu siç është edhe në mese të tjera në Kosovë, *Drini i Bardhë*, *Lumbardhi i Shalës*, *Ibar-lumë i bardhë* (rrëthi i Mitrovicës), *Lumbardhi i Pejës*⁶, *Lumbardhi i Deçanit* etj.

Kemi mjaft emërtime të bigëzuara shqipe e sllave si *Ana e Drinit*, treva e *Anadrinit*, është shquar nga elementi sllav vazhdimisht *Podrimlje*, *Rrethi i Bjeshkës së Prizrenit* në administratën serbe është evidentuar përherë *Podgorje*, *Prizrensko Podgorje*, po kështu ka ndodhur gati me shumicën e vendbanimeve në rrethinën e Prizrenit, sa për shembull: *Gurra-Poslisht*, *Vërmi(c)a-Vërbnica*, *Malësia e Re-Nova Shumadia*, *Arbënesh* (Arbëria) - *Leskovec* (nga leska - lajthi, druri i lajthisë), *Fshati i Ri- Novo Selo*, *Fshati Epërm-Gornje Selo*, *Syziu i Poshtëm-Nasheci i Poshtëm* etj. Padyshim se edhe gjatë sundimit osman do të kemi emërtime që e shquajnë kohën e pushtimit, në këtë anë, ku janë përfshirë të gjitha fushat. Një degë e Lumbardhit të Prizrenit që derdhet në këtë lumë, pak mbi qytetin e Prizrenit, shquhet me emër që heq origjinë orientale: *Karapotok: Uji i Zi*, më lart në këtë trevë të Grykës së Lumbardhit është vendi i *Dyzet Pusave*, që po kështu me orientalizëm: *Kërk Bunar*, prej këndeje kemi edhe familje që e mbajnë edhe mbiemrin: *Kërk* (numër-dyzet). Me emra të këtillë janë edhe një numër i vendbanimeve si: *Atmaxhë*, *Karashingjergj-Shëngjergj*, *Has- Shulla* etj.

Emri i një lagjeje të Prizrenit është *Bazhdarhane*, mësohet nga banorët se emrin e ka marrë nga se në këtë lagje është bërë pagesa e tatimit (bazhdarit) të prodhimeve që janë tregtuar. Një pjesë e fushës në perëndim të Prizrenit quhet *Atmejdani*, vend ku janë lëshuar në garën e vrapimit kuajt etj. Një rrugë e një lagjeje në jugperëndim të Prizrenit ka ndërruar shumë emra, gjegjësisht sipas

⁴ Xh. Gosturani, Dr. Hilmi Agani: *Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit*, në "Studime filologjike", Tiranë, nr. 4, 1988, f. 159.

⁵ S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës*, f. 338.

⁶ M. Halimi, *Vështrime gjuhësore*, Prishtinë, 1993, f. 271.

Rreth disa aspekteve të së folmes shqipe të qytetit të Prizrenit...

pushtuesve. Banorët këtë rrugë e shquajnë si vend ku është tregtuar bulmeti, prodhimet e qumështit, si ai i lopëve, dhenve dhe i dhive, gjegjësisht tregu i prodhimeve blegtorale, pra kryesisht rruga ku janë tregtuar prodhimet e dhalltit të dhenve dhe të dhive. Elementi sllav kurrë nuk ka mundur ta theksojë në mënyrë origjinale këtë emërtim të kësaj rruge, shpesh është përbuzur përdorimi si: rruga: *Llallellije*, ngase, siç dihet, në alfabetin serb nuk ekziston dhëmborja *dh*. Një banor i kësaj lagjeje, profesor i ish SHLP-së “Xh. Doda” në Prizren, F. Ostrozubi, i deshifron emrat e kësaj rruge sipas kohës së pushtimeve: *Llallo Bogazi* (dhallë + boazi [bozë-pije e përbërë me miell misri], një lloj i bozës), në kohën e pushtimit osman. Më tutje shquan se emri *Llallo* lidhet me një luftëtar turk, nga kemi edhe mbiemra familjar: *Llallollar-i*, etj. Më pas në kohën e pushtimeve serbe rruga emërtohet: *Pançevačka*; në kohën e pushtimit italian (1941-1944) emërtimi ndërrohet në: *Roma*, në kohën e ripushtimit socialist serb ajo do të riemërtohet, *Rruga e Beogradit*, etj.

Në këtë pikë, domethënë të emërtimit të vendeve, rrugëve, vendbanimeve ku përballë ndodhen bashkësi gjuhësore të përfshira në bashkësinë shoqërore sllave siç ka ndodhur në këtë hapësirë, padyshim se ka pasur qëndrime nacionaliste e shoviniste serbe⁷, por edhe të tjerëve në dëm të popullatës vendëse pra të shqiptarëve. Emërtimi në administratë është bërë jo në gjuhën përkatëse me alfabet përgjegjës, madje jo me alfabet latin, por kryesisht me atë cirilik. Kështu edhe shkrimi i të porsalindurve është bërë me alfabet cirilik. Edhe sot e kësaj dite ka probleme me emërtimet e emrave të ndryshëm të anasve të kësaj treve. Në regjistrat e sotëm, të trashëguar nga administrata e pushtetit sllav: mungesa jo vetëm e dhëmbores, *dh*, që e shquam më sipër, por edhe fonemave të tjera si: *th*, *y*, të alfabetit serb kanë qenë edhe paratekst i shfrytëzuar mirë që t’i bastardojë jo vetëm emërtimet e njerëzve, por edhe të të gjitha fushave të tjera. Për shembull emri *Bardh*, gjithmonë është përdorur në variantin *Barll*, Drini i *Barll*, *elle* pesë (edhe pesë) etj.

Mbiemri *Bytyçi* kurrë nuk është shkruar në formën e tij të drejtë, por *Bitiçi* ose *Butuçi* etj. Ndonëse popullata nuk e ka njohur shkrimin cirilik, ai çdokund, pra jo vetëm në administratë është përdorur për qëllime shoviniste, si në media të shkruara e të folura ashtu edhe në institucione të ndryshme: në shenjëzime të rrugëve, në mbishkrime të shesheve, në emërtime të qyteteve, në mbishkrime të tregtoreve etj. Shkrimi i cirilikës ka pasur përparësinë shtetërore dhe është përdorur edhe për arsye të ushtrimit të dhunës brutale⁸ ndaj popullatës në këtë anë. Krahës këtyre qëndrimeve shovene në administratë synohej edhe ndarja kombëtare e elementit shqiptar në *albanci dhe shqiptari*, duke e ndarë elementin shqiptar të Kosovës nga banorët e Republikës së Shqipërisë. Këtu nuk kanë munguar as edhe keq interpretimet e identitetit kombëtar të shqiptarëve, madje

⁷ A. të ndryshëm: *Shpërngulja e shqiptartëve gjatë shekujve*, SHKTHSHK, Prishtinë, 1992, f. 290.

⁸ B. Krizman, *Elaborat dra Ive Andrica iz 1939 godine*, IHRP, Hrvatska, 11/1977, f. 77-90.

edhe duke e përcëmuar me emërtime alternative fyese si: *shiftari*, *shiptari*, *shkiptari*, *shkipe shipeci*⁹ etj.

Në fushën e ndërndikimeve nuk duhet mohuar edhe ndikesën e shqipes në këtë gjuhë të mjedisit, kryesisht në thjeshtimin dhe shfaqjen e parafjalëve që ngërthejnë në vete elemente të të dy gjinive që veçohen në arealet e të folmeve të këtyre bashkësive si për shembull: / *Trazhe* gu na dve tri meste / - që e ka kuptimin se vajzën e kërkojnë në dy tre vende (fjala është për vajzën që e kërkojnë për fejesë), / *Njoj gu uzmi jabuku* / - që shquan kuptimin se asaj-familjes së vajzës, pra merrja mollën etj. Kësisoj ka shumë fjalë e fraza që janë në ndërndikime gjuhësore, më tutje në këtë aspekt do të përvijonim, si: / *Videja gu kod reku* / - që ka kuptimin se vajzën, atë e pashë te reka: / *Skočija sa čardak* / - që përdoret në kuptimin se ai apo ajo ka kërcyer nga çardaku! Që në këtë anë të ligjërimeve ka shquar një ligjërim të përzierë. Siç shihet sistemi i vjetër rasor i kësaj gjuhe është pjesë e inventarit leksikor të këtyre ligjërimeve, ndonëse sikurse shprehet M. Blaku në vështrimin: “Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës”¹⁰, paradigma e lakimit të emrave pasqyron një rrëgjim edhe më të madh të këtij sistemi brenda dialektologjisë serbe me një shtrirje mjaft të gjerë gjeografike jo vetëm në territorin e të folmeve të Kosovës si dhe këtyre arealeve që i kemi bosht në trajtimin tonë, por edhe jashtë kufijve të Kosovës¹¹. Autori me të drejtë këtë e sheh si një gërshetim i gjurmëve të mbetura nga sistemi i vjetër autokton i lakimit dhe i ndikimeve të forta nga jashtë, qoftë nga gjuhët sllave, qoftë edhe nga gjuhët joslave, gjegjësisht por në mënyrë të veçantë edhe ndikimit të gjuhës shqipe¹². Në një vizitë që bëmë në Grykën e Lumbardhit të Prizrenit, gjegjësisht në fshatin e largët të këtij areali, Manastir (Manastircë), siç e quajnë vendasit emrin e vendbanimit, hasëm në shumë emërtime të cilat edhe dita-ditës në mënyrë të shkëlqyeshme e ruajnë trajtën e tyre të vjetër në fjalorin ligjërimor të të folurit të banorëve. Gjithashtu në këtë aspekt për pikat që e përafrojnë gjuhën e të folmeve të këtyre arealeve që flasin boshnjakisht e serbisht në kuadër të raportit të kontaktit me gjuhën shqipe, bëmë edhe një vizitë plotësuese për lëvizjen si dhe shkallën e kësaj lëvizjeje të këtyre çështjeve gjuhësore. Me theks të veçantë në pikat që përputhen, por edhe të atyre që largohen në këto raporte ndërgjuhësore. Nga kjo vizitë, përkatësisht nga subjektet dialektologjike të këtij areali të Rrethit të Bjeshkës së Prizrenit është parë qartë se e folmja shqipe shquan përmasa shumë më të mëdha të përdorimit në fjalorin e kësaj treve. Derisa para Luftës së fundit në Kosovë përdorimi i gjuhës shqipe në arealin e Skorobishtit në raport me gjuhën boshnjake ishte 50% me 50%, tash pas Luftës të gjithë banorët e këtij areali mësimet i ndjekin në gjuhën shqipe. Përndryshe vendbanimi i Skorobishtit numëron rreth 280 shtëpi, madje është qendër gravitimi e disa fshatrave të kësaj

⁹ R. Ismaili, *Nacionalno ime albanaca*, SANU, OJK, Libri i VII-të, Bg., 1987, f. 111.

¹⁰ M. Blaku, *Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës*, “Gjurmime Albanologjike, 23-1993, f. 67.

¹¹ B. Koneski, *Historia makedonskog jezika*, III, Beograd. 1966, f. 121-123.

¹² P. Ivić, *Dijalektologija srpskohrvatskog jezika*, N. Sad, 1956, f. 120-121.

Rreth disa aspekteve të së folmes shqipe të qytetit të Prizrenit...

treve. Në familje në përdorim e kanë gjuhën boshnjake si dhe gjuhën shqipe¹³, siç thamë edhe më lart. Fusha e ruajtur më së miri është ajo e emrave të farefisnisë, afri së familjare, të riteve të ndryshme, zakonisht në adete shumë të ngjashme, besojnë në qenie të ngjashme mitologjike, rrëfejnë përralla e tregime të natyrës fare të afërt etj. Nga fusha e emrave: *axha, çika, nusja*¹⁴, *dasma, besa, çeif, çorr, loqka, bukë, gjiza, vdekja, hupësi. tasha, fistan* etj. Kryesisht emrat e këtyllë i kanë bërë ballë fushës së egër të asimilimit, pra jo vetëm strukturës, por edhe kulturës dhe gjuhës së etnisë autoktone të kësaj ane. Në ligjërim boshnjak përdoren të pandryshuara edhe me bazë të kuptimit të parë. Në këtë kuptim gjen shtrirje në këto fraza edhe fjala *çikë*¹⁵, por, që i është modifikuar natyrës së huaj gjuhësore, si: / *Dosho axho dva put po njoj!* / - (*Ka ardhur xhaxhai dy herë për atë!*), / *Rekla çika ne pa ne!* / - që thënia e sinjifikon kuptimin se çika ka thënë *jo dhe jo*. Është me interes të theksohet se fjala që shënon vajzën, gocën, pra çikën që përdoret në këto areale të Grykës së Lumbardhit si dhe atë të Rrethit të Bjeshkës së Prizrenit të bashkësive gjuhësore boshnjake, sinjifikon edhe në të folmen e Rahovecit, që është në kufi të së folmes së Anadrinit, ku përdoret fjala *çora*¹⁶, që gjithashtu e ka kuptimin e fjalës *vajzë, gocë, çikë*. Në trevën e kësaj së folmeje banorët ligjërimin e tyre e shquajnë për gjuhë boshnjake, herë-herë edhe *nashinski*¹⁷, që e ka kuptimin: “flasim në gjuhën tonë”, “në gjuhën e trevës sonë” shprehen folësit e vendbanimit të fshatit Manastiricë të arealit të Grykës së Lumbardhit të rrethit të Prizrenit. Këtu kemi evidentuar edhe një numër shprehjesh të tjera që veçohen në këtë aspekt: për personin që ka të meta në të folur, domethënë që “ngatërrohet” gjatë të folurit, pra *belbëzon*, në të folurit e këtij areali thuhet: / *On je belbe!* / - Ai belbëzon, gjegjësisht ngatërrohet në të folur apo gjatë komunikimit, madje si të tillë sinjifikohen edhe ata që nuk shprehen lehtë, apo edhe ngurrojnë t'i thonë gjërat edhe pse flasin mirë. Në ritin e fejesë e të martesës, kur caktohet dita e dhënies së fjalës së fejesës, dërgimi i *maramës* (peshkirit), ose me rastin e martesës, kur dërgohen *teshat* (rrobat e nuses), në pritjen e përgatitur nga miqtë që e përcjellin bijën e tyre, ku thjesht flitet për krushqit, bisedohet për numrin e dasmorëve, për gra si dhe për burra, se sa do të jenë përafërsisht, në mënyrë që miku, babai i nuses të përgatitet për mirëpritjen e tyre, sidomos të *kerrave të grave* dhe të *kerrit të nuses* (fjala është për makina të marrjes së nuses), prandaj thuhet: / *Ne mu dali nikakav caktim!* / - që ka kuptimin se nuk i kanë dhënë kurrfarë caktimi. Kryesisht kur është fjala për ndonjë veçim a për ndonjë dallim të ndonjë gjëje apo të ndonjë sendi në mesin e frazave të tjerave në ligjërimin e këtyre të folmeve dëgjohet edhe: / *Nema nikakav dallim!* / - që do të thotë se nuk ka kurrfarë

¹³ Subjekt dialektologjik: Bajram Xhaferi, banorë i përhershëm i fshatit, plak 70 vjeçar, kryeplak i fshatit.

¹⁴ S. Idriz, *Uticaj albanskog jezika na govor i narodnu poezije Gore (dorëshkrim)*.

¹⁵ E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, SGJ, Prishtinë, 1986, f. 100.

¹⁶ S. Cena, *Disa elemente të gjuhës shqipe në popullsinë e Rahovecit*, GJASSHF, Prishtinë, f. 322.

¹⁷ M. Adžemi, *Našnica* (upustvo za čitanje i pisanje), Prizren, 2004.

dallimi, se nuk ka kurrfarë ndryshimi etj. Ashtu siç është edhe në arealet e tjera të të folmeve të Prizrenit me rrethinë edhe në këto areale të këtyre të folmeve riti i ceremonisë mortore është i njëjtë. Në kuadër të fjalëve të ndryshme ngushëlluese përdoret edhe shprehja që në një mënyrë apo në tjetër e ngushëllon edhe ata që i pranojnë ngushëllimet, por edhe ata që e bëjnë këtë ngushëllim: / *Mu došla deka!* / që e ka kuptimin se i ka i ka ardhur vdekja, pra e pati kohën e vdekjes, *e mori vdekja* që edhe e priste etj. Në bosht të kësaj shprehjeje të frazës së këtyre arealeve që flitet boshnjakisht e aty këtu edhe serbisht, fjala është e burimit të gjuhës shqipe: *deka*.¹⁸ Nga sa shënuam me këtë rast shihet qartë se presionit të asimilimit të gjuhës së këtyre anasve deri më sot më së shumti i ka bërë ballë fusha e emrave në krahasim me kategoritë e tjera gramatikore të këtyre të folmeve në trevën e Grykës së Lumbardhit të të folmeve të Prizrenit me rrethinë. Në mesin e shprehjeve të tjera kemi shtuar edhe një numër të fjalëve e fjalive të ndryshme që përdoren në areale të këtyre të folmeve të Grykës së Lumbardhit, në ato të Rrethit të Bjeshkës së Prizrenit që kanë shtrirje edhe në mese të tjera të këtyre të folmeve si dhe në vetë të folmen e qytetit të Prizrenit. Ka momente që në jetë edhe janë dëshpëruese, por edhe të tilla që janë trimëruese, në këtë përvijim përdoret edhe shprehja që shquan një përmbyllje të një mendimi, si: / *As forca ništa na možesh!* / - Me forcë asgjë nuk mundesh. / pra në kuptimin se me forcë asgjë nuk mund të arrish. Padyshim se jeta sjell edhe të mira, por herë-herë edhe ngatërresa të natyrave të ndryshme, madje qofshin ato edhe të natyrës më të rëndë. Në këto tërthore të zgjedhjeve të shprehjeve për ta arsyetuar, apo për t'ua bërë të ditur opinionit këtë çështje përdoret edhe shprehja: / *Nije on u gabim!* / në kuptimin se ai nuk është gabim dhe i është dashur që të veprojë etj. Rëndësi ka fusha e fjalive që e shquajnë përdorimin e fjalës germe, shkronjave të alfabetit: / *Ne zna josh sve germe!* / në kuptimin se nxënësi që duhej t'i mësonte shkronjat e alfabetit dhe se edhe nuk i din të gjitha. Këtu shquajmë kuptimin e përdorimit të kësaj fjale pa e mohuar edhe përdorimin edhe në situata të tjera në këto të folme. Në një rrethanë tjetër, në këtë anë përdoret edhe fraza që në boshtin e saj e ka fjalën e gurrës shqipe *krah*¹⁹: / *Nema krah on!* /. Tutje, drita me vajgur ka qenë mjeti që për një kohë të gjatë i ka shërbyer njeriut, pra ka kapur fazë të një periudhe të rëndësishme në jetën e tij. Duke qenë pjesë e jetës padyshim se ka pasur shprehje për e rreth këtij përdorimi. E tillë është edhe kjo shprehje: / *Llampa ima numru!* / që e kemi shënuar në vizitat tona hulumtuese në trevën e Grykës së Lumbardhit si dhe në trevën e të folmeve të Rrethit të Bjeshkës së Prizrenit, gjegjësisht në arealin e së folmes së vendbanimit të Skorrobishtit. Kjo shprehje përdoret zakonisht kur për arsye të caktuara kur dritat me vajgur kompletohen me qelqin e sipërmë, për dritë më efektive. Siç kemi theksuar edhe më lart fjala bosht që përdoret në këtë kontekst të kësaj shprehjeje është fjala që e ka përdorimin e gurrës shqipe me gjenezë nga gjuha latine *numër*²⁰. Për t'i realizuar dëshirat ka edhe momente, që

¹⁸ E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, SGJ, Prishtinë, 1986, f. 117.

¹⁹ E. Çabej, *Po aty*, f. 291.

²⁰ E. Çabej, *Po aty*, f. 384.

Rreth disa aspekteve të së folmes shqipe të qytetit të Prizrenit...

nuk mund të afrohen ose edhe nuk mund të realizohen, prandaj njeriu i lutet tjetrit që të i realizojë synimet, qofshin ato edhe të fushës së dashurisë, qofshin ato edhe të fushës së pajtesave njerëzore apo edhe të dëshirës së familjes. Në këtë kuptim e kemi edhe fjalinë që përdoret në këtë anë që ka në përdorim fjalën shqipe lutje: / *Lutju mu çinili* / e përdorur në kuptimin se i kanë bërë lutje. Mysafirët gjithmonë kanë qenë gëzim i pritur me kureshtje në shtëpi, por jo vetëm në këtë anë, pra i mbarë traditës sonë kombëtare. Madje ata kanë qenë nderi dhe vetë “nami i derës” së asaj shtëpie. Ajo shtëpi që ka pasur më shumë mysafirë është shquar për shtëpi më me nam, në kuptimin *më e rëndë*, madje është mëtuar të jetë kullë, vend ku shquhet ndenja, biseda (muhabeti) dhe vetë “tempulli” i dijes dhe i pushkës, shpjegojnë në këtë anë. Po në këtë anë përdoret edhe shprehja: / *Dosli musafiri!* / - (erdhën mysafirë), në kuptimin se erdhën mysafirë dhe duhet të kemi kujdes edhe në pritje e edhe për sjellje etj. Po në këtë kontekst të këtyre meditimeve në këto areale të këtyre të folmeve përdoret jo rrallë, por shumë e dendur, gjithashtu e po kësaj natyre të mikpritjes në këtë anë: / *Desi bre mik?* / - (*Ku je bre mik?*), në kuptim të mirë të shoqërisë së mirëfilltë, pra jo vetëm për mikun, njeriun shokun, jaranin, por edhe për atë që shquan cilësi të kuptimit më të mirë. Pra në bosht të përdorimit të këtyre fjalive kemi përdorimin e fjalëve që kanë, padyshim edhe ndikesën e drejtpërdrejtë të origjinës së leksikut të të folmeve të gjuhës shqipe, ndonëse ne nuk e kemi shteruar mendimin tonë për këtë çështje jo të padiskutueshme për këtë. Në momente të ndryshme, siç dëgjohet nga anasit e trevës së Grykës së Lumbardhit, gjë që e dëshmojnë edhe subjektet tanë dialektologjike përdoret edhe fjala *përparim*, sidomos në situata kur dëshirohet të theksohet ngecja në fusha të ndryshme të jetës qoftë në kuadër të familjes qoftë edhe në sferën shoqërore dhe integritet të saj: / *Nema nikakav përparim* / që ka kuptimin se nuk ngritje në mësim, nuk ka përmirësim të shëndetit si dhe raste të tjera të natyrës gjegjëse të kuptimit të thënies në fjalë. Edhe në sferën e shkollimit hetohen përdorime të ndryshme të sferave të ndryshme të ndikimit të shqipes si p.sh.: / *Koliko mungesa imam?* / që ka kuptimin se sa mungesa i kam bërë në shkollë. Po kështu edhe shprehja e po kësaj natyre: / *Koji mësim s'mo imale?* / që ka kuptimin se nga ora e kaluar e mësimi se cilin mësim e kemi mësuar, që zakonisht e përdorin në arealin e së folmes së Rrethit të Bjeshkës së Prizrenit, si Lugishtë të Prizrenit e gjetiu. Në vijim, mendojmë se pikërisht sa i përket kësaj natyre të njohjes së gjuhës së këtyre arealeve të kësaj së folmeje i përgjigjen edhe fjalët që nuk janë të pakta në fjalorin e këtyre të folmeve si fjala *lesh* e *plak*. Nga ngatërresat që janë momente jo të rëndomta në këtë anë, në këto raste njeriu mund të gjendet në pozita edhe të palakmueshme në dëshmimin e ngjarjeve që mund të jenë edhe rezultat i emocioneve të nduarnduarta ta përdorë edhe shprehjen: / *Ga nagradali mu lesh!* / që mund të shquajë edhe kuptimin se i kanë folur shumë, po edhe se e kanë rrahur shumë etj. Ndërsa fjala *plak* është mjaft dëftuese në gjuhën shqipe, jo përse i përket etimologjisë së saj, por pikërisht se shumë fenomene gjuhësore lidhen me këtë fjalë në gjuhën shqipe. Më tutje, kjo fjalë është indikative se shënon një gjendje e cila është vazhdimisht pjesë e botës njerëzore rreth së cilës lidhen edhe shumë mendime e meditime që kapin fusha të ndryshme

të vetë jetës sonë shoqërore. Ajo shënon edhe një fund të një jete, por fjala *plak* shënon edhe një pjesë të historisë së jetës së dhembshme, që është e domosdoshme për ta mbijetuar deri te fundi i fatit: / *Ga uzella pleqnija!* /. Kjo sintagmë e kësaj ane që në bosht të saj ka fjalën shqipe *plak* që është edhe dëshmuar e gjithë mendimit në boshtin e saj ka një përdorim mjaft të përhapur. Megjithatë ne e morëm vetëm për ilustrim këtë shembull ajo ka shtrirje edhe në sfera të tjera të shprehjes në të folmen e sotme të këtyre arealeve. Një fjalë e urtë tjetër që përdoret mjaft dendur në arealet e së folmes së qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij është: / *Çka di dhija çka është taxhija!* / Kjo fjalë e urtë zakonisht përdoret në raste kur njeriu ndodhet para disa gjërave që ka mundësi të zgjedhë më të mirën, por kur e bën zgjedhjen e një gjëje, sendi apo diç tjetër jo të duhur, nga të tjerët mund të rivlerësohet edhe me mendimin se nuk ka arritur ta bëjë zgjedhjen e duhur, përkatësisht ka zgjedhur atë që është më pak e vlershme, më pak e mirë, apo edhe më pak e bukur, prandaj me perifrazë në mënyrë të drejtpërdrejtë përdoret kjo shprehje. Madje ndonjëherë edhe e bastarduar në strukturën shprehëse të saj për shkak të mospërdorimit të drejtë të tingullit *dh* në të folmet e këtyre bashkësive gjuhësore: / *Shka di llija shka është taxhija!* / E thamë këtë, jo vetëm për ta cituar këtë fjalë të urtë, por për të pasqyruar këtë pikë takimi që është fare pranë arealeve të këtyre bashkësive etnike gjuhësore, e sidomos të folmes boshnjake si dhe të të folmeve të arealeve të së folmes shqipe në këtë anë. Qoftë momenti, qoftë rasti, qoftë edhe cilido akt tjetër i përdorimit të kësaj fjale të urtë shquan ngjashmëri të përdorimit identikë në interpretimin e domethënies si dhe të kuptimit. Gjithashtu edhe për fjalën tjetër të urtë të gjuhës shqipe që ka përdorim të dendur jo vetëm në arealet e së folmes sonë që i kemi temë të trajtimit, por edhe shumë më gjerë në këtë aspekt: / *Cofi dhija u prish miqësia* / e cila dëgjohet në përdorimin e bashkësive të kësaj treve sado pak e modifikuar në gjuhën përkatëse, boshnjake, por edhe serbe etj. Pra kësajsoj: / *Cofi llija u prish miqësia!* / etj. Në përdorim të këtyre të folmeve është edhe fjala që shquan ngjyrën e zezë, si fjalë e vetme dhe në vetë strukturën e fjalive të ndryshme si: / *Faqja e zezë!* / *Kakve e zeza mu puklla?! / Nemoj mu činiti të zeza!* / etj. Fjalët kanë kuptime që në thelb shquhet e zeza, pra jo e mira. Këtu po i evidentojmë edhe një numër frazash të tjera, por gjithashtu mendojmë se kjo mund të jetë një pjesë e vogël nga sa ne mendojmë, të cilat priten edhe më të trajtohen në mënyrë të mirëfilltë: *A će igrano hupësi!* (A po luajmë kush humb!); karakteristikë e gjuhës shqipe: dukuria e shurdhimit të bashkëtingëlloreve. *Daj mi tesha da se obucem!* (Mi jep rrobat (teshat) të vishem!), *Ajde da jedemo bukë.* (Eja të hamë bukë.), *Ti si moja loqka!* (Ti je loqka ime!), *Daj mi shamiju.* (Ma jep shaminë.), *A po kuptojsh što ti zborim?* (A po kupton se çka po të flas.), *Donesi jelek!* (Më sill jelekun!), *Imam çef da sedim s`tobom!* (Kam dëshirë të rri me ty!), *Ne se pravi çorr!* (Mos u bëj i verbër!), *Desi majčin bire!* (Ku je biri i nënës!), *Ajde mori motra!* (Ajde mori motër!), *Krejt si otišao!* (Ke shkuar krejtësisht!), *Si ošov po tupani!* (Shkove për tupana!) etj. Nga sa kemi shquar për kontaktet e gjuhës shqipe me të folmet e arealit të Grykës së Lumbardhit që kryesisht e përdorin gjuhën boshnjake, ndryshethënë me atë serbe del se kontaktet ndërgjuhësore të shqipes me bashkësitë

Rreth disa aspekteve të së folmes shqipe të qytetit të Prizrenit...

ndërgjuhësore të këtyre arealeve nuk janë të njëjta. Këtu padyshim se duhet të theksohet se në arealin e së folmes së qytetit të Prizrenit dhe rrethinës në ligjërimin e shkujdesur përdoren edhe një numër fjalësh të ndryshme që heqin gjenezën sllave si: *struj* (rrymë), *bollicë* (spital), *lubenicë* (shalqin), *samoposllugë* (vetëshërbim), *nameshtaj* (mobilje), *komshilluk* (fqinjësi), etj. Padyshim se fushat e kontakteve të ligjëritit të gjuhës së bashkësisë gjuhësore boshnjake me shqipen nuk janë vetëm në fushën gjuhësore, por edhe në fusha të tjera të disiplinave të tjera jogjuhësore që konvergojnë në këtë aspekt. Koha e gjatë e dominimit sllav në këtë anë ka bërë që edhe në raportet e ndërndikimeve gjuhësore të lënë gjurmët e tyre sidomos në ndërrimin e gjuhës së *zembrës* në gjuhë të *bukës* së kësaj treve të lashtë gjuhësore.

